



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1586/2 Prot.

Tiranë, më 02.12.2024

**V E N D I M**

**Nr. 291, Datë 02.12.2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 242, datë 21.11.2024, e paraqitur nga z. A.K kundër Bashkisë Durrës me pretendimin për diskriminimin për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese shpjegon se: “Jam një nëpunës i Bashkisë Durrës pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit me statusin e nëpunësit civil, që prej vitit 2010. Prej vitesh tashmë, bazuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2023, unë bashkë me 4 kolegë në Qendrën Ekonomike të Arsimit paguheshim me këtë VKM, sipas lidhjes nr. 1, kategoria IV (Ekzekutive), grupi IV-2, njësoj me të gjithë specialistët e tjerë të Bashkisë. Përveç diskriminimit përkundrejt kategorive drejtuese, që nga i larti e deri tek i ulëti tek VKM e lartpërmendur, me VKM e re, nr. 421, datë 26.06.2024, përveçse diskriminimi përkundrejt kësaj kategorie vazhdon, madje rritet në përmasa të papara, mua bashkë me 4 koleget, në QEA Durrës, na bëhet edhe një diskriminim tjetër pasi të gjithë kolegët specialistë kategorizohen në lidhjen nr. 1, kategoria IV (Ekzekutive), grupi IV-2, me pagë për pozicion 80.000 lekë, neve na bëhet paga për pozicion 75.000 lekë, pra pa pozicion, duke na diskriminuar kështu edhe përkundrejt kolegëve. Qendra Ekonomike e Arsimit është pjesë e Bashkisë Durrës e cila merret me administrimin e mirëmbajtjes dhe mirëmenaxhimit të të gjithë institucioneve arsimore nën juridiksionin e Bashkisë Durrës.

Pozicioni im në Qendër është “Specialist i të ardhurave dhe Buxhetit”. Më poshtë po ju bëj përlllogaritjen e rrogës time me elementët përbërës:

- |   |                                     |
|---|-------------------------------------|
| 1. Paga për pozicion                                      | 75.000 lek                          |
| 2. Pagesa e diplomës                                      | 14.000 lek                          |
| 3. Vjetërsia 28 vjet: 10 vjet x 0.6% x 75.000 = 4.500 lek |                                     |
|   | 10 vjet x 0.8% x 75.000 = 6.000 lek |
|   | 8 vjet x 1% x 75.000 = 6.000 lek    |
- 

Gjithsej: 105.500 lek

Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore  $105.500 \times 0.112\% = 11.816$  lek

Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi  $105.500 - 30.000 = 75.500 \times 0.13\% = 9.815$  lek

Pra, paga ime neto është  $105.500 - (11.816 + 9.815) = \underline{83.869}$  lek

Paga e kolegëve që deri dje merrnin të njëjtën pagë me mua (përveç kolegëve të zyrës), sot është:

- |   |                                     |
|---|-------------------------------------|
| 1. Paga për pozicion                                      | 80.000 lek                          |
| 2. Pagesa e diplomës                                      | 14.000 lek                          |
| 3. Vjetërsia 28 vjet: 10 vjet x 0.6% x 75.000 = 4.500 lek |                                     |
|   | 10 vjet x 0.8% x 75.000 = 6.000 lek |
|   | 8 vjet x 1% x 75.000 = 6.000 lek    |
- 

Gjithsej: 110.500 lek

Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore  $110.500 \times 0.112\% = 12.376$  lek

Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi  $110.500 - 30.000 = 80.500 \times 0.13\% = 10.465$  lek

Pra, paga neto e kolegëve është  $110.500 - (12.376 + 10.465) = \underline{87.659}$  lek

Sic e shihni për një vendim të cilin mund ta quajmë kapriço, paga ime përkundrejt një homologu i cili nuk është pjesë e Qendrës Ekonomike të Arsimit, luan me 3.790 lek në muaj, ose 45.480 lek në vit”.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe ti vendoset në vend dinjiteti i nëpërkëmbur me këtë lloj kategorizimi dhe interpretimi që i bëhet VKM-së, duke diferencuar punonjësit.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *““Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga subjekti ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 27.11.2024, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues, informacion dhe dokumentacion lidhur me shkakun e diskriminimit.

Në vijim, subjekti ankues, nëpërmjet e-mail-it të datës 27.11.2024, duke falenderuar Komisionerin për interesimin dhe gadishmërinë e treguar, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94<sup>1</sup>/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me*

---

<sup>1</sup> *“Tërheqja e ankesës”*.

*kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, z. A.K i cili me anë të kërkesës të përcjellë nëpërmjet e-mail-it datë 27.11.2024, është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur nga subjekti ankues në datën 27.11.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 242, datë 21.11.2024, të paraqitur nga z. A.K kundër Bashkisë Durrës, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 242, datë 21.11.2024, të z. A.K kundër Bashkisë Durrës, për arsye se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**